



SHLP “MESDHETARE E SHQIPËRISË”

RREGULLORE PËR ORGANIZIMIN DHE PUNËN E NJËSISË SË SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE KURRIKULAVE

Neni 1 Baza ligjore

Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe zhvillimit të kurrikulave (NJSBCK) është një strukturë e ngritur pranë SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” për të siguruar nivelin e cilësisë së procesit të mësimdhënies. Kjo njësi funksionon në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë në RSH Nr. 9741, datë 21.5.2007, me ndryshimet përkatëse, Statutin e SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” dhe Rregulloren e organizimit të institucionit.

Neni 2 Përbërja

NJSBCK përbëhet nga 3 anëtarë, përkatësisht: 1 anëtar nga Fakulteti i Shkencave Ekonomike, me propozim nga Dekani, 1 anëtar nga Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Politike, me propozim nga Dekani, 1 anëtar nga Rektorati. Anëtarët e NJSBCK kanë mandat 3 vjeçar dhe aprovohen nga Senati jo më vonë se një javë pas skadencës së mandateve paraardhëse. Të gjitha ndryshimet, shkarkimet dhe zëvendësimet në përbërjen e njësisë bëhen nga Rektorati.

Neni 3 Objekti i veprimtarisë

3.1. Misioni i kësaj njësie është të garantojë zbatimin e procedurave të aprovuara nga organet drejtuese nëpërmjet kontrollit dhe vlerësimit të procesit mësimor në aspektin e mësimdhënies. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Kurrikulave realizon funksionet e saj nëpërmjet metodave të vlerësimit dhe vetëvlerësimit, duke bërë të mundur përmirësimin dhe rritjen e cilësisë së brendshme në institucion.

3.2. Detyrat kryesore të njësisë janë:

- ✓ Të kontrollojë procedurat e mësimdhënies në aspektin e përmbajtjes, sipas udhëzimeve që e rregullojnë atë, dhe të zbatimit të orarit mësimor. Sekretaria i ve në dispozicion të gjitha dokumentat e nevojshme për realizimin e kësaj detyre.
- ✓ Të monitorojë zbatimin e planeve të kontrollit të pedagogëve nga njësitë kryesore dhe njësitë bazë, si dekanati dhe departamenti. Njësia përpunon dhe analizon rezultatet e kontrollit vertikal sipas formularëve përkatës.

- ✓ Te analizoje cilesine e mesimnxenies nepermjet analizave te tezave te provimit, objektivititetit te vleresimit te tyre, si dhe zbatimin e te gjitha procedurave ne kete drejtim.
- ✓ Te ndjeke dhe monitoroje te gjitha procedurat e pas vleresimit te studenteve dhe te garantoje te drejten e ankimimit te vleresimit ne te gjitha instancat perkatese.
- ✓ Njësia gjykon ne aspektin e zbatimit te procedurave edhe te gjithe ato elemente qe lidhen me praktiken mësimore, detyrat e kursit, diplomat, punen e pavarur te studenteve.

Neni 4 **Anketimet**

4.1 Njësia është organi kryesor qe realizon anketimet per matjen e performances se pedagogeve ne procesin mësimor, per vleresimin e infrastruktures mësimore, per vleresimin e punes me studentet dhe te secretarise mësimore.

4.2 Per kete qellim Njësia perdor anketat dhe pyetesoret, qe i vihen ne dispozicion nga Rektorati dhe / ose Zyra e Burimeve Njerëzore.

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Kurrikulave ne bashkëpunim me rektoratin, dekanatin dhe Zyrën e burimeve njerëzore, realizon edhe pyetësorin për pedagoget, me ane te metodës se vetëvleresimit. Ky pyetësor përmban kryesisht te dhëna për cilësinë e mësimdhënies nëpërmjet procesit akademik, raporti me studentet, te dhëna për punën kërkimore-shkencore.

4.3 Njësia realizon mbledhjen dhe perpunimin e rezultateve e tyre.

Neni 5 **Koha e anketimeve**

Anketimet per vleresimin e performances se pedagogeve behen perpara provimit perfundimtar ne fund te çdo semestri dhe ne kohe te pershtashme per te lehtesuar vleresimin objektiv te studenteve. Ato mund te plotesohen sipas rasteve ose nga nje grup studentesh te zgjedhur, perfaqesues te klasave ku pedagogu jep mesim, ose nga te gjithe studentet pa perjashtim. Kete e percakton forma e anketes qe do te perdoret per te matur performacen e mësimdhënies. Anketimet jane te fshehta.

Neni 6 **Perpunimi i anketimeve**

Te gjitha anketimet perpunohen sipas modelit te percaktuar ne ankete. Perpunimi i anketimeve dhe vleresimi i pedagogeve sipas qellimit te anketimit, shoqerohet me nje raport te hollesishem si ne aspektin metodik ashtu dhe ne aspektin e rezultateve. Te gjitha materialet e anketimeve i vihen ne dispozicion Zyres se burimeve njerëzore dhe Rektoratit.

Rezultatet e anketimeve i vihen ne dispozicion dekanatit, i cili me pas vlerëson punën e bere nga çdo pedagog dhe ne rast problematike zhvillohen diskutime me pedagogun përkatës për zgjidhjen dhe përmirësimin e tyre. Zyra e burimeve njerëzore ruan cdo vit raportin e anketimeve dhe bazohet ne te per propozimet mbi rruget dhe mjetet per permiresimin e cilësisë.

Neni 7

Bashkepunimet

Njësia e vlerësimit të brendshëm të cilësisë në punën e vet gjen mbështetjen e gjithë organeve drejtuese që janë të interesuara për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mesimnxënies. Ajo bashkepunon ngushtë me departamentet, dekanatet dhe rektoratin, të cilat i vënë në dispozicion të gjitha materialet e nevojshme për realizimin e misionit të saj.

Njësia, për probleme të veçanta të objektit të saj, mund të marrë ndihmën e personelit të specializuar brenda institucionit dhe jashtë tij. Të gjithë ekspertizat e jashtme aprovohen nga rektorati.

Neni 8

Kurrikula

Permirësimi i vazhdueshëm i kurrikulave, që ka për qëllim rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe mesimnxënies, realizohet në zbatim të strategjive të institucionit dhe akteve juridike të tij. Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe kurrikulave ndjek dhe kontrollon zbatimin e procedurave që zbatohen nga dekanati dhe departamenti për ndryshimet në syllabuset dhe programeve të studimeve të miratuara.

Neni 9

Vlerësimi

Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe kurrikulave harton një raport vjetor të punës së saj, i cili i paraqitet Rektoratit. Rektorati bën vlerësimin e punës së kësaj njësie, aprovon raportin dhe miraton programin e punës për vitin pasardhës. Të gjitha raportet përfundimtare të njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe kurrikulave protokollohen dhe arshivohen, në përputhje me aktet juridike të institucionit.

Tiranë, më __/__/2015

SENATI AKADEMIK
I SHLP MESHDETARE E SHQIPËRISË

K R Y E T A R I

Prof. Asoc.Dr. Nexhmi DUMANI